



VENDIM

Nr. 48, Datë 29.04.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIM E SHOQËRISË
“XHENGO ENERGJI” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KASOLLET E SELCËS”**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10 pika 3 të Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.04.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “XHENGO ENERGJI” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për licensimin e kësaj shoqërie në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Kasollet e Selcës';

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “XHENGO ENERGJI” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3 gërmat “a”, “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni tekniko – ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5 gërmat “a” dhe “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit (Neni 9 pika 3 gërma “c”)
- Leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike (neni 9 pika 4.1.5 gërma “b”), do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/ të Pjesëshëm dhe Rinovimit të Licensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “XHENGO ENERGJI” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-i “Kasollet e Selcës” me fuqi të instaluar 4000 KW.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI